



Акционерско друштво во државна сопственост  
за вршење на дејноста давање услуги во  
воздухопловната навигација

Shoqëri aksionare në pronësi shtetërore për kryerjen e  
veprimtarisë, dhënie të shërbimeve të navigacionit ajror

## SHA “M-NAV” SHKUP

# Plani financiar vjetor për vitin 2021

*Nëntor 2020*



## IDENTIFIKIMI I DOKUMENTIT

**Përshkrimi i dokumentit:** Plani vjetor financiar i SHA "M-NAV" Shkup i vitit 2021, i cili i përfshin efektet e pandemisë Kovid-19 – Konteksti evropian, trafiku ajror në Republikën e Maqedonisë së Veriut më 2019-2020 dhe skenare të mundshme të lëvizjes gjatë vitit 2021, njësia e çmimit për fluturimet e shërbimeve të aviacionit dhe ato terminale gjatë vitit 2021, analiza e të ardhurave të planifikuara për vitin 2021, analiza krahasuese e të ardhurave të planifikuara të shoqërisë për vitin 2021 në raport me të ardhurat e planifikuara të shoqërisë për vitin 2020, analiza e shpenzimeve të planifikuara për vitin 2021, paraqitja tabelare e të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara të Shoqërisë për vitin 2021, rezultati i planifikuar financiar i Shoqërisë për vitin 2021, analiza krahasuese e shpenzimeve të planifikuara të Shoqërisë për vitin 2021, me shpenzimet e planifikuara të Shoqërisë për vitin 2020, analiza krahasuese e shpenzimeve të planifikuara të Shoqërisë për vitin 2021, me shpenzimet e realizuara të Shoqërisë për vitin 2020 e të tjerë.

**Titulli**

**SHA "M-NAV" SHKUP  
PLANI VJETOR FINANCIAR PËR VITIN 2021**

<b>Numri referues</b> MNV-610-201-04	<b>Numri i botimit</b> 1.0
	<b>Data</b> 27/11/2020

**Ekstrakti**

"...Planifikimi i të ardhurave të fluturimeve për vitin 2021, bazohet në analizat e trafikut ajror në Republikën e Maqedonisë gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2020, si dhe në skenarët e fundit të përgatitur nga EUROCONTROL-i për numrin e fluturimeve në periudhën e viteve 2020-2024, që janë prekur drejtpërdrejt nga pandemia Kovid-19, e cila pothuajse preku gjithë botën..."

**Fjalët kyç**

Vëllimi i trafikut, të ardhurat e planifikuara, shpenzimet e planifikuara, të ardhurat e realizuara, shpenzimet e realizuara, të ardhurat e përgjithshme, shpenzimet e përgjithshme.

<b>Statusi i dokumentit:</b>	Versioni i punës		<b>Klasifikimi:</b>	Dokumenti i brendshëm	
	Versioni i saktë	√		Dokumenti publik	√
	Botimi i shpallur			I besueshëm	

<b>Lokacioni:</b>	<b>Shkup</b>
-------------------	--------------

**PRANIMI I DOKUMENTIT**

Në tabelën vijuese janë paraqitur autorët dhe personat të cilët e kanë përpunuar/miraturar këtë dokument.

<b>Funksioni</b>	<b>Emri, mbiemri dhe nënshkrimi</b>	<b>Data</b>
Përpunuan:	Filip Trandafillovski Këshilltar i pavarur i Njesisë së planifikimit, të zhvillimit dhe të huamarrjes ndërkombëtare Daniela Trajçulleska Shefe e Njesisë financiare dhe administrates  Dejan Zaraqçiev Këshilltar i pavarur për përcaktimin e çmimeve	
Kontrolloi Aspekti - cilësia	Leonora Shala Shefe e Seksionit të cilësisë - Sigurisë në Njësine e sigurisë, të sigurimit dhe të cilësisë	
Me pajtim të	Olivera Micevska Udhëheqëse e Njesisë për planifikim, zhvillim dhe huamarrje ndërkombëtare	
Miratoi	Fahrudin Hamidi Kryetar i Bordit drejtues dhe Drejtor ekzekutiv i Fluturimit ajror  Vladko Krstevski Anëtar i Bordit drejtues dhe Drejtor ekzekutiv i Teknikës së fluturimit ajror  Migjen Salmani Anëtar i Bordit drejtues dhe Drejtor ekzekutiv i Çështjeve financiare, i çështjeve juridike, i zhvillimit dhe i investimeve	

**PËRMBAJTJA**

1. HYRJE ..... **Error! Bookmark not defined.**
2. EFEKTET E PANDEMISË KOVID-19 – KONTEKSTI EUROPIAN..... **Error! Bookmark not defined.**
  - 2.1. Parashikimi i Eurocontrol – STATFOR-it për trafikun ajror 2020-2020 (Botimi më datën 04.11.2020). **Error! Bookm**
3. TRAFIKU AJROR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT GJATË VITEVE 2019 – 2020 DHE SKENARËT E MUNDSHËM TË LËVIZJES NË VITIN 2021 **Error! Bookmark not defined.**
4. ÇMIMI I VETËM I FLUTURIMEVE AJRORE NË VITIN 2021 ..... **Error! Bookmark not defined.**
5. ÇMIMI I VETËM I “M-NAV”-it PËR SHËRBIME TERMINALE ..... **Error! Bookmark not defined.**
6. ANALIZA E TË ARDHURAVE TË PLANIFIKUARA PËR VITIN 2021 .... **Error! Bookmark not defined.**
  - 6.1. Analiza krahasuese e të ardhurave të planifikuara të Shoqërisë për vitin 2021 ndaj të ardhurave të planifikuara për vitin 2020 **Error! Bookma**
7. ANALIZA E SHPENZIMEVE TË PLANIFIKUARA PËR VITIN 2021..... **Error! Bookmark not defined.**
8. REZULTATI I PLANIFIKUAR FINANCIAR PËR VITIN 2021 ..... **Error! Bookmark not defined.**
9. PASQYRA TABELARE E TË ARDHURAVE TË PLANIFIKUARA TË SHA “M-NAV” SHKUP PËR VITIN 2021 ..... **Error! Bookmark not defined.**
10. PASQYRA TABELARE E SHPENZIMEVE TË PLANIFIKUARA TË SHA “M-NAV” SHKUP PËR VITIN 2021 ..... **Error! Bookmark not defined.**
11. ANALIZA KRAHASUESE E SHPENZIMEVE TË PLANIFIKUARA TË SHA “M-NAV” SHKUP PËR VITIN 2021 ..... **Error! Bookmark not defined.**
12. ANALIZA KRAHASUESE E SHPENZIMEVE TË PLANIFIKUARA TË SHA “M-NAV” SHKUP PËR VITIN 2021, ME SHPENZIMET E REALIZUARA TË SHOQËRISË PËR VITIN 2020 **Error! Bookmark not defi**

## 1. HYRJE

Në bazë të nenit 60 të Ligjit të Aviacionit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 14/06, 24/07, 103/08, 67/10, 24/12, 80/12, 155/12, 42/14, 97/15, 152/15, 27/16, 31/16 и 64/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 220/19), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për kryerjen e shërbimeve të navigacionit themelon Shoqëri Aksionare me një aksionar, shteti – ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror, në përputhje me Ligjin e Shoqërive Tregtare.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë në seancën e mbajtur më 16.10.2008, mori vendim për rifillimin e procedurës së themelimit të një Shoqërie Aksionare, në pronësi shtetërore, për kryerjen e veprimtarisë: “Ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror” nr. 19-4602/1.

Me vendimin për ndryshimin e statutit të Shoqërisë Aksionare në pronësi shtetërore për kryerjen e veprimtarisë “Ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror” (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 70/19) dhe vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të Shoqërisë Aksionare, në pronësi shtetërore, për kryerjen e veprimtarisë “Ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror” SHA “M-NAV” Shkup (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 24/20) është ndryshuar emri i Shoqërisë, në përputhje me faktin se Shoqëria Aksionare vepron dhe merr pjesë në qarkullimin juridik si ndërmarrja: **“Shoqëri Aksionare në pronësi shtetërore për kryerjen e veprimtarisë “Ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror”, SHA “M-NAV” Shkup**”. Shkurtimisht emri i ndërmarrjes është SHA “M-NAV” - Shkup.

### ➤ **Lënda e punës në SHA “M-NAV” SHkup**

Si lëndë pune në Shoqëri llogariten këto veprimtari:

1. Sigurimi i shërbimeve të navigacionit ajror (ANS – Air Navigation Services) si veprimtari parësore e Shoqërisë, i cili mbulon në vete:

1.1 Shërbime të MTA-së:

a) shërbimet SHTA

- kontrolli i trafikut ajror (ATC – Air Traffic Control), e cila u jepet avionëve duke dhënë leje dhe udhëzime për kontrollin kompetent të fluturimit që të mundësohet fluks i sigurt, i rregullt dhe i shpejtë i trafikut ajror;

- informimi gjatë fluturimit (FIS – Flight Information Service), i cili mundësohet sipas dhënies së informatave të rëndësishme për zhvillimin e sigurt të trafikut ajror;

- alarmi (ALRT – Alerting Service) që i jepet avioni, i cili ka nevojë për kërkim dhe shpëtim, nëpërmjet njoftimit dhe koordinimit të subjekteve kompetente,

b.) rregullimi i fluksit të trafikut ajror (ATFM – Air Traffics Flow Management), me të cilën mundësohet shfrytëzimi maksimal i kapacitetit të kontrollit të fluturimit dhe vëllimit të trafikut;

c.) menaxhimi i hapësirës ajrore (ASM – Air Space Management), me çka mundësohet shfrytëzimi maksimal dhe fleksibël i hapësirës ajrore për të gjithë shfrytëzuesit;

ç) funksionet e rrjetit (Network functions), janë shërbime që jepen për të siguruar aranzhmanë për sjelljen e vendimeve të përbashkëta ndërmjet shteteve anëtare, ofruesëve të shërbimeve të navigacionit ajror dhe funksioni për menaxhin e rrjetit.

1.2. Shërbimi i informimit aeronautik (AIS – Aeronautical Information Service), të cilat përfshijnë: grumbullimin, përpunimin dhe shpërndarjen e informatave të aviacionit, njoftimet urgjente qarkore informative të aviacionit, kartelat e aviacionit, mënyrat dhe procedurat e fluturimit;

1.3. shërbimet meteorologjike që përfshijnë grumbullimin, përpunimin dhe shpërndarjen e informatave të distribuimit, parashikimin meteorologjik, njoftimet meteorologjike dhe paralajmërimet meteorologjike;

1.4. Instalimi, mirëmbajtja, kontrolli dhe monitorimi i mjeteve teknike, aparate dhe pajisje për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror, që nënkupton mirëmbajtjen preventive dhe korrigjuese, përshtatjen, kalibrimin, monitorimin, mbikëqyrjen, udhëheqjen, vendosjen dhe vënien në punë, si

dhe zhvillimin dhe ndryshimin e procedurave dhe udhëzimet për funksionin dhe mirëmbajtjen e mjeteve teknike-operative, në një gjendje që mundëson një trafik ajror të sigurt dhe të rregullt.

2. Mbajtja e evidencës, grumbullimi, përpunimi dhe përcjellja e të dhënave, të cilat shfrytëzohen për pagesën e kompensimeve të shërbimeve të navigacionit ajror.

3. Përgatitja dhe përditësimi i rregullt i Pëmbledhjes për informatat e aviacionit.

4. Trajnimi i personelit ANS

➤ **Ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror, financohet nga:**

- pjesa e kompensimit e realizuar në bazë të shërbimeve të navigacionit ajror, shuma e së cilës llogaritet me koston e ofruesit të shërbimeve të navigacionit ajror në mënyrë të përshkruar në përputhje me nenin 56 (4) të Ligjit të Aviacionit,
- kompensimi për trajnimin e personelit të ANS-së
- taksat, huatë, kreditë dhe ndihma të tjera financiare dhe teknike.

## **2. EFEKTET E PANDEMISË KOVID 19 – KONTEKSTI EUROPIAN**

**Pandemia Kovid-19 që preku gjithë rajonin European e më gjerë gjatë vitit 2020, para së gjithash kishte një sulm të drejtpërdrejtë dhe katastrofik ndaj trafikut ajror dhe aviacionit në përgjithësi, si segment kyç i aviacionit dhe ndaj ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror në rajonin European dhe më gjerë. Duke marrë parasysh ndikimin e saj të vazhdueshëm dhe të pritshëm edhe për vitin 2021, SHA “M-NAV Shkup”, si në vitin 2020, ashtu edhe për vitin 2021, do të ballafaqohet me një rënie drastike të trafikut, për dallim nga periudha para pandemisë, si dhe me implikime financiare të drejtpërdrejta të Shoqërisë.**

### **2.1. Parashikimi i Eurocontrol – STATFOR për trafikun ajror 2020-2024/ (Botimi i datës 4.11.2020)**


Parashikimi i trafikut ajror i ofruar nga ana e Eurocontrol – STATFOR paraqet ndikimin e madh të pandemisë Kovid-19, nga pamja e trafikut ajror në të ardhmen, duke marrë parasysh inputet e mëposhtme:

- **Trendet e trafikut ajror: 65% më pak fluturime gjatë muajve mars – tetor të vitit 2020, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2019.**

Në fillim të vitit 2020 (janar – tetor), numri mesatar i fluturimeve ditore në Europë (ECAC region) ishte 54% nën nivelin e trafikut, me të njëjtën periudhë gjatë vitit 2019, siç shihet në grafikun e mëposhtëm.



## Recent trends in flights in European airspace




Source: Eurocontrol. Each line is a national airspace. Smoothing: 7 days.

- **Rritja ekonomike: Revizion i fortë rënës i parashikimit ekonomik (raporti i Oxford Economics 2020)**

Shumica e shteteve ballafaqohen me revizion rënës të parashikimeve ekonomike përgjatë periudhës (2020-2024).

Cumulative Change in GDP growth



Source: Oxford Economics, Release: 23 October 2020

Cumulative change = The total net percent change of the GDP growth by State between the GDP forecast used in this forecast and the one used to produce the forecast in March 2020 (unreleased).


- **Tre skenarë të veçuar, të cilët duhet të merren parasysh për ndikimin e KOVID-19 dhe kohën e nevojshme për normalizimin e trafikut ajror**

Eurocontrol-i është përcaktuar për 3 skenarë të veçuar, në bazë të të gjitha rreziqeve të mundshme dhe ndikimeve relative të tyre, ndërsa gjatë përpunimit të skenarëve, marrin parasysh parametrat vijues:

- Intensitetin e valës së dytë të Kovid-19 në botë
- Intensitetin dhe kohën e kufizimeve të dhëna nga shëndeti publik dhe distancimi social
- Disponueshmërinë dhe përdorimin e vaksinave / terapive me sukses të dëshmuara për shërimin nga KOVID-19
- Ndikimin në ekonominë globale, nga normalizimi i fortë i shpejtë në krizën financiare
- Dallimet e mundshme në ndihmën shtetërore dhe rreziqet nga falimentimi në industrinë e aviacionit (industrinë e aviacionit)
- Rënien potenciale të kërkesës së fluturimeve, jo vetëm për pasagjerët e bizneseve (p.sh.: pjesëmarrja e lartë në video-konferencat ...), por edhe për pasagjerët të cilët udhëtojnë në mënyrë rekreative (p.sh.: grupet më të prekura).

### Skenarët e KOVID-19 për normalizimin e trafikut ajror

<b>Skenari nr.1</b>	Vera 2021 Vaksina	<u>Përhapje e gjerë e vaksinave për pasagjerët (ose fundi i pandemsë) deri në verën e vitit 2021.</u> <u>Normalizimi në nivelin e vitit 2019, në vitin 2024.</u>
<b>Skenari nr.2</b>	Vera 2022 vaksina	<u>Përhapje e gjerë e vaksinave për pasagjerët (ose fundi i pandemsë) deri në verën e vitit 2022.</u> <u>Normalizimi në nivelin e vitit 2019, në vitin 2026.</u>
<b>Skenari nr.3</b>	Mosefektiviteti i vaksinës	<u>Infeksion afatgjatë dhe besueshmëri e ulët e pasagjerëve.</u> <u>Normalizimi në nivelin e vitit 2019, në vitin 2029.</u>





### 3. TRAFIKU AJROR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT NË VITET 2019-2020

Implementimi i konceptit të Free Route Airspace në vitin 2016 ishte shembulli i shkëlqyer i bashkëpunimit ndërmjet ofruesve të shërbimeve në rajon dhe të gjitha këto kontribuan në normalizimin e linjave ajrore dhe krijimin e linjave ajrore më të shkurta dhe më fleksibël. Njëkohësisht, kjo ka çuar në një rritje të numrit të fluturimeve në hapësirën tonë ajrore, si dhe kursime të karburantëve të kompanive ajrore dhe ulje të emitimit të dioksidit të karbonit. Me implementimin e organizimit të ri të hapësirës ajrore, njëherësh u vendosën procedura të reja me kontrollet e fluturimeve nga shtetet fqinje. Me shfrytëzimin optimal të të gjitha resurseve operative dhe angazhimin shtesë të kontrolluesve të fluturimeve, të cilët veçmë kaluan në shumë trajnime për t'u përballur me ngarkesën e madhe të punës, në mënyrë të sigurt dhe efikase i shërbyen vëllimit të shtuar të trafikut. Krahas kësaj, u respektuan të gjitha standardet e vendosura për sigurimin e shërbimeve, duke mos shkaktuar vonesë nga ana e kontrollit tonë të fluturimeve. Të dhënat dëshmojnë se në vitin 2019, në ditën më të stërngarkuar, kontrolli ynë i fluturimeve shërbeu me 1,113 fluturime ajrore.

Megjithatë, që në fillim të muajit mars të vitit 2010, pothuajse të gjitha aktivitetet që i referoheshin punës së Shoqërisë, ishin me shenjë e pandemisë Covid-19. Në fakt, pas vendosjes së masave fillestare për mbrojtjen e të punësuarve, SHA "M-NAV" Shkup, duke ndjekur para së gjithash rregulloret dhe rekomandimet e Qeverisë së RMV-së dhe në përputhje me dokumentet relevante ndërkombëtare (EUROCONTROL Guidelines for Contingency Planning of Air Navigation Services, 2009), menjëherë formoi Shtabin e Krizës për parandalimin dhe mbrojtjen nga përhapja e virusit Korona, i cili do ta ndjekë dhe do të reagojë në përputhje me të gjitha situatat e reja të krijuara, duke mos harruar se hapësira ajrore mbi vend, duhet të jetë e hapur dhe të shërbehen klientët të cilët veprojnë në atë periudhë. Shërbimin e kontrollit të fluturimit e shfrytëzuan të gjitha fluturimet mjekësore, kargot, riatdhesimet, si dhe një numër i vogël i fluturimeve civile.

Gjatë muajve të verës, që nga korriku e deri në shtatorin e vitit 2020, filluan lëvizjet e caktuara në trafik në kahje pozitive, për shkak të ndërprerjes së politikave restriktive, gjithsesi, për shkak të moskoordinimit të masave të vendosura nga ana e shteteve individuale të BE-së, kjo i preku të gjitha vendet në Evropë dhe më gjerë, ndërsa trafiku ajror ballafaqohet edhe më tutje me një rënie të ndjeshme.

Në fakt, në 10 muajt e parë të vitit 2020 (periudha janar-shtator), u realizuan gjithsej 77.949 nisje, prej të cilave 71.027 ishin fluturime, gjë që flet për rënie me **57,5%**, për dallim nga numri i fluturimeve të së njëjtës periudhë të vitit 2019. Sipas statistikës së Byrosë Qendrore për pagesë të Eurocontrol-it, për 9 muajt e parë të 2020-ës, Republika e Maqedonisë së Veriut regjistroi rënie të njëjësive të pagesës së fluturimeve për **56,9%**, për dallim nga periudha e njëjtë e vitit 2019.

Month	2020 Actual	2020 Unit Rate Basis	2019 Actual	2018 Actual	% 2020 A / 2020 F	% 2020 A / 2019 A	% 2019 A / 2018 A
	(1)	(2)	(3)	(4)	(1)/(2)	(1)/(3)	(3)/(4)
1 January	22.672	17.941	17.708	14.025	26,4%	28,0%	26,3%
2 February	20.493	16.858	16.639	12.637	21,6%	23,2%	31,7%
3 March	14.355	19.487	19.233	16.461	-26,3%	-25,4%	16,8%
4 April	3.678	28.801	28.427	22.091	-87,2%	-87,1%	28,7%
5 May	4.181	40.989	40.456	33.230	-89,8%	-89,7%	21,7%
6 June	5.417	46.583	45.978	39.336	-88,4%	-88,2%	16,9%
7 July	17.682	51.216	50.551	44.955	-65,5%	-65,0%	12,4%
8 August	25.368	51.284	50.618	45.563	-50,5%	-49,9%	11,1%
9 September	21.882	45.936	45.339	40.169	-52,4%	-51,7%	12,9%
10 October		38.475	37.975	33.523			13,3%
11 November		20.878	20.607	17.495			17,8%
12 December		21.752	21.469	16.970			26,5%
<b>TOTAL</b>	<b>135.729</b>	<b>400.200</b>	395.000	336.455	<b>-57,5%</b>	<b>-56,9%</b>	17,4%

- Pasqyra tabelare e Byrosë Qendrore për pagesën e Eurocontrol-it, për njësitë e pagesës të realizuara nga fluturimet mbi RMV-në, gjatë periudhës prej 01.1 e deri më 30.9.2020

Njëkohësisht, për shkak të mbylljes së dy aeroporteve ndërkombëtare, atij të Shkupit dhe atij të Ohrit, uljet dhe ngritjet u reduktuan vetëm në ngarkesa, në mënyrë postare dhe fluturime për riatdhesimin e qytetarëve. Gjatë muajve prill, maj dhe qershor të vitit 2020, shkalla e uljes arriti kulmin e saj dhe u regjistrua rënie e trafikut për më shumë se **90%**, ndërsa për periudhën janar-shtator të vitit 2020, ulja e numrit të operacioneve ishte përafërsisht **59%**, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019. Për rikuperimin në nivel të vendi, është e nevojshme të mënjanohen kufizimet e fluturimeve, të vendosura nga vendet anëtare të BE-së, sepse 77% e trafikut të aeroporteve maqedonas, përqëndrohet në Bashkimin Europian.

Gjatë gjithë periudhës së kaluar, SHA "M-NAV" Shkup, kishte udhëzime dhe procedura të qarta se si duhet vepruar dhe punuar, kur të fillojë normalizimi i trafikut. Në këtë kontekst, u ndërmorën hapa të caktuar në aspekt të ruajtjes së sigurisë në nivel të lartë, si dhe përgatitjes operative për t'iu përgjigjur kërkesave të përdoruesve të shërbimeve. SHA "M-NAV" Shkup dhe ekipi menaxhues i Shoqërisë, gjatë gjithë kohës ndjekin situatën e pandemisë dhe në mënyrë adekuate dhe në kohë të duhur, ndërmarrin të gjitha aktivitetet e nevojshme, si dhe masat e sigurisë dhe ofrimin e sigurt të shërbimeve të aviacionit.

Për momentin, është shumë mosmirënjohëse të parashikosh rritje, duke marrë parasysh të gjitha sfidat e shkaktuara nga pandemia Covid-19 në industrinë e aviacionit. Parashikimet për rimëkëmbjen dhe normalizimin e trafikut ajror, si dhe skenarët e mundshëm të rrjedhës së trafikut për periudhën 2020-2024 (janë publikuar dhe 3 skenarë nga ana e Eurocontrol më 4.11.2020), akoma nuk janë të favorshme për industrinë e aviacionit. Skenari më optimist nga tre të mundshmit, parashikon një rimëkëmbje të ngadalshme, e cila do të zgjasë disa vite dhe normalizimi i trafikut pritet vetëm në vitin 2024, përkatësisht kthim në nivelin e njëjtë si para krizës së pandemisë.

Në përputhje me këta tre skenarë të Eurocontrol, pritet që rritja e numrit të përgjithshëm të fluturimeve në hapësirën ajrore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021, të lëvizë ndërmjet 14,1 përqind (gjatë skenarit pesimist) dhe 69,3 përqind (gjatë skenarit optimist), krahasuar me vitin 2020. Gjatë përllogaritjes së njësisë së çmimit për fluturimet e vitit 2021 në RMV, SHA "M-NAV" Shkup, fillon nga supozimi i një rritjeje të numrit të njësive të paguara të fluturimeve për 45%, krahasuar me numrin e njëjtë në vitin 2020.

## Republika e Maqedonisë së Veriut

Skenare	Rritje									
	2015	2016	2017	2018	2019	2020/2019	2021/2020	2022/2021	2023/2022	2024/2023
Skenari 1						-56,3%	69,3%	25,3%	10,8%	8,3%
Skenari 2	3,9%	-4,3%	17,5%	12,7%	15,5%	-56,5%	16,8%	48,2%	16,2%	13,7%
Skenari 3						-56,5%	14,1%	19,3%	17,2%	13,2%

- Rritja e trafikut në RMV, gjatë periudhës 2020-2024 (skenarët e mundshëm të Eurocontrol-it)

## 4. ÇMIMI I VETËM I FLUTURIMEVE AJRORE GJATË VITIT 2021

Metodologjia e përllogaritjes së çmimit të njësisë së fluturimeve, bazohet nga sistemi i përbashkët i pagesës së kompensimeve të fluturimeve, në përputhje me Rregulloren nr.1794/06 të Komisionit Europian, si dhe vendimit të Qeverisë së RMV-së, për mënyrën e përcaktimit të shumës së komensimit, për shfrytëzimin e shërbimeve të navigacionit ajror, mënyrës së pagesës dhe përjashtimit nga pagesa e kompensimit, si dhe shumës dhe mënyrës së përcaktimit të pjesës së kompensimit të shfrytëzimit të shërbimeve të navigacionit ajror ("Gazeta Zyrtare e Republikës së

Maqedonisë së Veriut” nr.194 më 23.9.2019). Informacioni për llogaritjen e çmimit të fluturimeve vendoset, shqyrtohet dhe më pas miratohet nga ana e Eurocontrol-it dhe pilotëve, gjatë mbledhjes këshilluese, që organizohet çdo vit. Përveç kësaj, në këtë mbledhje shkëmbehen informacionet e shpenzimeve të përgjithshme të planifikuara, investimet, si dhe vëllimi i pritshëm i trafikut, për çdo vit vijues.

Sipas harmonizimit të kryer ndërmjet ASH “M-NAV” Shkup dhe Agjencisë së Fluturimeve Civil të RMV-së, si organ rregullator, çmimi i vetëm i fluturimeve në RMV për vitin 2021, është përcaktuar të jetë **50,87 euro**, që njëkohësisht shënon rritje me 13,1%, krahasuar me nivelin gjatë vitit 2020.

### **Pasqyra grafike e lëvizjes së çmimit të vetëm të fluturimeve gjatë periudhës ndërmjet viteve 2012-2021 në RMV**



Vlen të theksohet edhe fakti se me rritjen e trafikut gjatë periudhës së kaluar dhe të ardhurave të fituara (krijuara) nga vëllimi i zmadhuar i shërbimeve të dhëna, u krijuan parakushtet e uljes së çmimit të fluturimeve. Megjithatë, në vitin 2020, për shkak të ndikimit katastrofik të pandemisë dhe rënies së pritshme të trafikut, ASH “M-NAV” vazhdimisht kryen analizë financiare, e cila duhet të japë pasqyrë më të qartë të likuidimit të Shoqërisë në kushtet e krizës. Njëkohësisht, u implementuan menjëherë masat antikrizë për uljen e shpenzimeve të përgjithshme në nivel vjetor për 17,3%. Nga përlogaritja e çmimit të vetëm të fluturimeve gjatë vitit 2021, u konkludua se edhe përkundër uljes së shpenzimeve të parapara për vitin 2021, në nivel që të mundësojë shërbim të pandërprerë dhe të sigurt të shërbimeve të navigacionit ajror, për shkak të ndikimit dramatik të pandemisë ndaj trafikut ajror, çmimi për njësi i fluturimeve gjatë vitit 2021, megjithatë duhet të rritet për 13%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, dhe mos ndikojë në përkeqësimin e aktiviteteve të mëtejshme që do të ndërmerren për rimëkëmbjen e trafikut ajror.

Në lidhje me periudhën që do të pasojë pas vitit 2021, çmimi i fluturimeve para së gjithash do të varet nga zhvillimi dhe kohëzgjatja e pandemisë, vëllimi i trafikut, si dhe nga ndikimi i investimeve kapitale të “Projektit të modernizimit të sistemit për kontroll të fluturimit të SHA “M-NAV”, ndaj çmimit të fluturimeve. Këto investime kapitale, kanë për qëllim kryesisht modernizimin teknik të sistemit të navigacionit ajror, rritjen e kapacitetit të hapësirës ajrore, mbi të gjitha ruajtjen e nivelit të duhur të sigurisë në trafikun ajror.

### **5. ÇMIMI I VETËM I “M-NAV”-IT PËR SHËRBIMET TERMINALE NË VITIN 2021**

Një pjesë e vogël e të ardhurave të përgjithshme të planifikuara (11%), SHA “M-NAV”

Shkup, shpreson t'i realizojë si ofrues i shërbimeve terminale të navigacionit ajror, përkatësisht shërbimeve të kontrollit të fluturimit gjatë ngritjes dhe uljes në Aeroportin e Shkupit dhe atë të Ohrit. Në sajë të këtyre shërbimeve, priten të hyra rreth 82 milionë denarë për vitin 2021, që është gjithashtu një ulje për 46%, krahasuar me të ardhurat e përgjithshme të realizuara nga shërbimet terminale në vitin 2019.

Sipas Marrëveshjes së Huasë me Bankën Europiane për rindërtimin dhe zhvillimin e financimit të "Projektit për ndërtimin e sistemit të navigacionit ajror" në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe për servisim efikas të detyrimeve të të njëjtit, çmimi i vetëm i shërbimeve terminale nga 1 prilli i vitit 2014, është 3,60 euro për ton të peshës maksimale të avionit gjatë ngritjes. Ajo nuk ka ndryshuar që nga periudha e kaluar, ndërsa SHA "M-NAV" Shkup planifikon të mbajë çmimin e njëjtë të shërbimeve terminale, në nivel të njëjtë edhe përgjatë vitit 2021.

## **6. ANALIZA E TË ARDHURAVE TË PLANIFIKUARA PËR VITIN 2021**

SHA "M-NAV" Shkup realizon të ardhura nga veprimtaria e tij, në bazë të pagesës së:

- kompensimit për ofrimin e shërbimeve të fluturimeve – faturimit dhe pagesës që në emër, a në llogari të SHA "M-NAV" Shkup e kryen EUROCONTROL-CRCO (Central Route Charges Office);
- kompensimit për ofrimin e shërbimeve terminale të navigacionit ajror – faturimit dhe pagesës që në emër, por në llogari të SHA M-NAV Shkup po ashtu e kryen EUROCONTROL-CRCO
- të ardhurave nga shërbimet e tjera (ofrimi i shërbimeve komunikuese dhe të radarit të Hungarocontrol-it nga ana e SHA M-NAV Shkup);
- të ardhura të tjera (të ardhura nga vitet e mëparshme, donacionet, qiratë etj.); dhe kompensimet për trajnimet e personelit të ANS-së.

Planifikimi i të ardhurave të fluturimeve në vitin 2021, bazohet në analizat e trafikut ajror në Republikën e Maqedonisë, gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2020, si dhe në skenarët e fundit të përgatitur të EUROCONTROL-it, për numrin e fluturimeve gjatë periudhës ndërmjet viteve 2020-2024, të cilat janë prekur drejtpërdrejt nga Pandemia Kovid-19, e cila preku gjithë botën.

**Sipas kësaj analize, për periudhën janar-dhjetor të vitit 2021, parashikohet të realizohen gjithsej të ardhura me vlerë 738.883.007,00 denarë, prej të cilave të ardhura për fluturimet 644.934.823,00 denarë, të ardhura për shërbimet terminale 81.948.184,00 denarë dhe të ardhura për shërbime të tjera 12.000.000,00 denarë, nga të cilat 10.000.000,00 në bazë të sigurimit të shërbimit të sigurimit të imazhit radar dhe shërbimeve të komunikimit të Hungarocontrol-it dhe 2.000.000,00 denarë të ardhura të tjera nga publikimi i informatave të aviacionit, të ardhurave për vitet e mëparshme, kompensimi i dëmeve, donacionet dhe të tjera.**

Të ardhurat planifikohen çdo tre muaj, në tremujorin e parë të vitit 2021 pritet të realizohen **77.271.519,44 denarë**, në të dytin planifikohet të realizohen **193.237.452,72 denarë**, në të tretin **297.548.319,50 denarë**, ndërkaq në tremujorin e katërt pritet të realizohen **të ardhura prej 170.825.714,90 denarësh**, që dëshmon karakterin sezonal të trafikut, i cili njëkohësisht reflekton edhe te të ardhurat.

Struktura e të ardhurave në parashikimet e planifikimit për vitin 2020 pritet të jetë: 87,3% të ardhura nga fluturimet, 11,1% të ardhura nga shërbimet terminale dhe 1,6% të ardhura të tjera.

Pasqyra tabelare e të ardhurave totale të planifikuara të "M-NAV"-it për vitin 2021, është dhënë në tekstin e mëposhtëm, Pika 9.

### 6.1. Analiza krahasuese e të ardhurave të planifikuara të Shoqërisë për vitin 2021, ndaj të planifikuara për vitin 2020

TË ARDHURAT	Të planifikuara v.2021	Të planifikuara v.2020	% 2021/2020
Të ardhurat e fluturimeve	644.934.823,00	948.951.519,00	-32,04
Të ardhurat e shërbimeve terminale	81.948.184,00	153.601.869,00	-46,65
Të ardhurat e tjera	12.000.000,00	12.000.000,00	-
<b><u>GJITHSEJ denarë:</u></b>	<b>738.883.007,00</b>	<b>1.114.553.388,00</b>	<b>-33,7</b>

Sipas Planit financiar vjetor të SHA "M-NAV" Shkup, vlera e të ardhurave të planifikuara për vitin 2021 është për 33,7% më e ulët në raport me të ardhurat e planifikuara për vitin 2020, si pasojë e ndikimit katastrofik të pandemisë ndaj trafikut ajror.

### 7. ANALIZA E SHPENZIMEVE TË PLANIFIKUARA PËR VITIN 2021

Shpenzimet totale të planifikuara përgjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2021, arrijnë vlerën e 777.687.000,00 denarëve, ndërsa të njëjtat krahasuar me shpenzimet totale të planifikuara të Shoqërisë për vitin 2020, janë në rënie për 30,0%.

Në fakt, duke mbajtur llogari para së gjithash për mjetet e nevojshme minimale për sigurinë e vazhdueshme në nivel të lartë të shërbimeve të sigurta, të rregullta, të shpejta dhe efikase të navigacionit ajror të përdoruesve në suaza të hapësirës ajrore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, masat ekonomike antikrizë e Bordit të Drejtorëve për uljen drastike të shpenzimeve totale të planifikuara të Shoqërisë në vitin 2021, është miratuar si rezultat i ndikimit të vazhdueshëm të pandemisë Kovid-19 edhe në vitin 2021, e cila para së gjithash ka ndikim të drejtpërdrejtë dhe katastrofik në aviacionin në tërësi, me ç'rast SHA "M-NAV" Shkup si në vitin 2020, po ashtu edhe në vitin 2021, do të ballafaqohet me ulje drastike të trafikut në raport me periudhën para pandemisë dhe me implikime financiare direkte në funksionimin e Shoqërisë. Duke marrë parasysh edhe pasigurinë ekstreme të situatës së pandemisë Kovid-19 si dhe ndikimin direkt të saj ndaj trafikut ajror dhe të ardhurave, Bordi i Drejtorëve i "M-NAV"-it, do të ndjekë në vazhdimësi gjendjet vijuese dhe aktualisht do të ndërmarrë masa shtesë për ruajtjen e cilësisë së lartë të shërbimeve të navigacionit ajror, si veprimtari bazë e Shoqërisë.

Nga gjithë kjo që u përmend më lartë, shpenzimet totale të planifikuara për vitin 2021, në mënyrë tabelare janë paraqitur në Pikën 10 – "Pasqyra tabelare e shpenzimeve të planifikuara të SHA "M-NAV" Shkup për vitin 2021", ndërkaq janë të grupuara sipas llojit të kostove, si më poshtë:

- Kostot totale për të punësuarit në vitin 2021 janë parashikuar në shumën prej 559.862.000,00 denarësh, a të njëjtat kanë pësuar rënie për 30,17%, krahasuar me kostot e planifikuara të Shoqërisë për vitin 2020, nga të cilat:

- Kostot e pagave bruto për të punësuarit në vitin 2021 arrijnë vlerën e 554.862.000,00 denarëve, të cilat krahasuar me ato të 2020-ës kanë pësuar rënie për 30,1%. Në të njëjtën kohë, te ky zë janë të përfshira edhe përlogaritjet e pagave bruto të 14 punësimeve të reja në gjysmën e dytë të vitit 2021, nga të cilat: 1 këshilltar/përkthyes në Sektorin e navigacionit ajror, 4 këshilltarë/inxhinierë dhe 2 përmbardues/teknikë për punë financiare, punë juridike, zhvillim dhe investime, si dhe vazhdimin e kontratave të punës me afat të pacaktuar për 11 studentë kontrollorë të kontrollit të fluturimeve për vitin 2021. Po ashtu, ky zë përfshin kostot për rritjen ligjore të pagave bruto në bazë të punës së kaluar, punës me turne, kompensimet e punës gjatë festave, si dhe rritjen e rejtingut të kontrollorëve të fluturimit.
- Zëri “Kostot e tjera për të punësuarit” kap vlerën e 5.000.000,00 denarëve dhe në krahasim me kostot e planifikuara për vitin 2020 kanë pësuar rënie për 37,5%. Këto mjete janë paraparë për pagesën e kompensimeve të tjera të punonjësve, d.m.th. kosto për kontrollimin sistematik të domosdoshëm, transportin jashtë Shkupit, kompensimet etj. Kostot për çmimet jubilarë dhe kostot e tjera sipas Kontratës kolektive të “M-NAV”-it nuk do të paguhen edhe në vitin 2021 sipas masave ekonomike antikrizë të ndërmarra nga Bordi i Drejtorëve të “M-NAV”-it, thënë ndryshe (p.sh.) të njëjtat janë zhvendosur për pagesë në vitin 2022, varësisht nga gjendjet aktuale të Pandemisë Kovid-19 dhe ndikimit të saj ndaj realizimit të trafikut, të ardhurave dhe gjendjes financiare të Shoqërisë në vitin 2022.
- **Kostot materiale totale për vitin 2021 janë planifikuar në vlerë prej 71.200.000,00 denarësh e të njëjtat kanë pësuar rënie për 27,2% në krahasim me kostot e planifikuara të Shoqërisë për vitin 2020, me ç’rast:**
  - Rënie më e madhe e zërave përkatës të kostove materiale totale hasim te kostot e planifikuara për pjesët rezervë të shpenzuara për 60% (të njëjtat të planifikuara me vlerë prej 12.000.000,00 denarësh), rënie për 36,7% të kostove të planifikuara për mirëmbajtjen (të planifikuara me vlerë prej 15.200.000,00 denarësh) në raport me shpenzimet e planifikuara të Shoqërisë për vitin 2020, si dhe kostot minimale të vlerësuara për të siguruar funksionimin e vazhdueshëm dhe të pandalshëm të sistemeve, duke pasur parasysh vjetërsinë e tyre, duhet maksimalisht të eliminohet çdo mundësi e ngecjes së tyre gjatë funksionimit, të sigurohet domosdoshmëria e intervenimeve në kohë dhe të shpejtë, furnizime të shpejta të pjesëve rezervë, si dhe ndërrimin e pjesëve të sistemeve gjatë vitit, në rast nevojë.
  - Zërat e tjerë të kostove materiale totale siç janë kostot e planifikuara për lëndët e para dhe materialet, kostot për shpenzimin e energjisë, kostot për shërbimet postare, telefonike dhe të internetit e të tjerë, sipas karakterit të tyre relativ, janë planifikuar në nivel të njëjtë si ato të vitit 2020.
- **Kostot totale jomateriale për vitin 2021 janë planifikuar në vlerë prej 67.125.000,00 denarësh dhe kanë pësuar rënie prej 45,6% në krahasim me kostot e planifikuara totale të Shoqërisë, për vitin 2020, ku:**
  - Kostoja e marrjes me qira të hapësirës për zyrë është menduar për marrjen me qira të hapësirës shtesë të zyrës për punonjësit e Sektorit FRPRRI dhe ato kanë pësuar rënie në krahasim me ato të 2020-ës, duke u bazuar në gjendjen aktuale të pandemisë Kovid-19 dhe prandaj ato janë planifikuar vetëm përgjatë tremujorit të fundit të vitit 2021.
  - Kostot për udhëtimet zyrtare dhe mëditjet për vitin 2021 me vlerë prej 15.000.000,00 denarësh kanë pësuar rënie për 57,1%, krahasuar me kostot e planifikuara gjatë vitit 2020, për shkak të pasojave të gjendjes me pandeminë Kovid-19 dhe mbylljen e vendeve përkatëse, takimet e rregullta të organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve janë

zëvendësuar me takimet telekonferenciale, si dhe duke pasur parasysh të gjithë situatën, shumica e trajnimeve, seminareve dhe pjesëmarrjeve në punëtoritë e punonjësve, për vitin 2022 janë anuluar.

- Kostot e planifikuara të sigurimit janë në vlerë prej 11.000.000,00 denarësh, prej të cilave 9.000.000,00 denarë për sigurimin e biznesit, 500.000,00 denarë për sigurimin e pronës, 400.000,00 denarë për sigurimin e kaskos, 300.000,00 denarë për sigurimin e personelit të Shoqërisë etj., dhe minimalisht kanë pësuar rënie krahasuar me kostot e vitit 2020, në përputhje me realizimin e perceptuar në dy vitet e fundit dhe nevojës për racionalizimin e kostove.
- Kostot e planifikuara për zërin “Anëtarësimet në organizata dhe të tjera” në vitin 2021 janë planifikuar në vlerë prej 1.625.000,00, denarësh, nga të cilat 1.600.000,00 denarë janë kostot për tarifat vjetore të anëtarësimin të “M-NAV”-it në organizatën ndërkombëtare CANSO (Organizata e Shërbimeve të Navigacionit Ajror Civil), në nivel evropian dhe botëror, ndërsa 25.000,00 denarë janë planifikuar për tarifat e anëtarësimin në shoqatat e brendshme për kontabilitet, revizion dhe mbrojtje gjatë punës dhe të njëjtat kanë pësuar rënie minimale krahasuar me kostot e planifikuara për vitin 2020, sipas nevojës së racionalizimit të kostove.
- Pjesa më e madhe e kostove jomateriale totale për vitin 2021 është zëri “Kostot e tjera jomateriale” me vlerë totale prej 35.000.000,00 denarësh, si vijon:

<b>Kostot e tjera jomateriale</b>	<b>2021</b>	<b>2020</b>	<b>%2021/2020</b>
Bordi Mbikëqyrës i Kompensimit	350.000,00	350.000,00	0,00
Honoraret	1.200.000,00	1.200.000,00	0,00
Trajnimi për CL, seminare dhe këshillime	6.000.000,00	33.000.000,00	-81,82
Revizioni (auditimi) i Raportit Financiar	250.000,00	200.000,00	25,00
Shërbimet e avokaturës	1.000.000,00	1.000.000,00	0,00
Shërbimet e tjera intelektuale	13.050.000,00	15.800.000,00	-17,41
Revistat dhe gazetatat profesionale	250.000,00	250.000,00	0,00
Certifikimi i AAC-së	10.700.000,00	10.500.000,00	1,90
Kostot e tjera jomateriale	1.000.000,00	1.500.000,00	-33,33
Donacionet në vend	1.000.000,00	1.000.000,00	0,00
Mirëmbajtja e softverit	200.000,00	200.000,00	0,00
<b>Gjithsej</b>	<b>35.000.000,00</b>	<b>65.000.000,00</b>	<b>-46,15</b>

Siç mund të shihet në tabelën e mësipërme, këto kosto në krahasim me të planifikuarat për vitin 2020, janë ulur në mënyrë drastike për (46,15%), ndërsa pjesa më e madhe e këtij zëri – “Kostot e tjera jomateriale”, përfshihet në kostot e këtyre nënzërave:

- Nënzëri për trajnimin e kontrollorëve të fluturimeve (KF), seminare dhe këshillime kap

vlerën e 6.000.000,00 denarëve për vitin 2021, nga të cilat 5.200.000,00 denarë janë paraparë për Sektorin e navigacionit ajror, për trajnimin e ripërtëritjes së njohurive për kontrollorët e fluturimeve, me autorizim të veçantë për njësinë e KF Shkup TWR/EXC dhe Ohër/ TWR/APP/EXC, shkollimin e 1 kontrollori të fluturimeve me ADI/TWR&APP autorizimin për OJTI-n, trajnimin për ripërtëritjen e njohurive për instruktor (OJTI/STDI Refresher course), dhënie të testit për mjet fluturues në gjuhën angleze për PKL (TEA), ndërsa për sektorët e teknikës së aviacionit dhe sektorin e FRPRRI-së janë paraparë kostot me vlerë prej 800.000,00 denarësh për trajnimet e nevojshme të personelit të aviacionit dhe punonjësve të tjerë.

- Shërbimet e tjera intelektuale në vlerë prej 13.050.000,00 denarësh, pjesa më e madhe e të cilave janë kosto të planifikuara për shërbimet konsultative në bazë të Kontratës së lidhur të shërbimeve konsultative për implementimin e projekteve të financuara me hua nga EBOR-i në vlerë prej 4.000.000,00 denarësh, incizim gjeodezik i Aeroportëve të Shkupit dhe Ohrit në vlerë prej 1.250.000,00 denarësh, mbikëqyrje për ndërtimin e ndërtesës ATM në vlerë prej 3.700.000,00 denarësh, mbikëqyrje për adaptimin e sallës teknike në vlerë prej 1.000.000,00 denarësh, komision për shërbimet e faturimit dhe pagesa e shërbimeve terminale të kontrollit të fluturimeve nga ana e Eurocontrol-it në vlerë prej 1.000.000,00, 2.000.000,00 denarësh për pagesë, sipas Kontratës për mbështetjen e vendeve anëtare të lidhura me Eurocontrol-in (Support to States Agreement) dhe kosto të tjera në kornizë të zërit: shërbime të tjera intelektuale.
- Si nënzë më i lartë përfshihen edhe kostot vjetore të certifikimit të SHA “M-NAV” Shkup, nga Agjencia e Aviacionit Civil me vlerë totale prej 10.700.000,00 denarësh.
- Nënzëri “Kostot e tjera jomateriale” në vlerë prej 1.000.000,00 denarësh, përfshirë edhe patundshmëritë e dhëna me qira (Antenë me qira në “Cërn Vërv”), kostot për ruajtjen e materialeve në arkivë, kostot për fotokopjime, vërtetimi i mosgjykimit për punonjësit, e të tjerë.
- Kostot e donacioneve në shtet janë paraparë në vlerë prej 1.000.000,00 denarësh për Federatën e Aviacionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- **Kostot e tjera të punës janë projektuar në vlerë prej 6.000.000,00 denarëve për vitin 2021.** Kjo kategori përfshin kostot e rezervimeve për kompensimin e punonjësve dhe rezervimet e kontratave, kostot e harmonizimit të vlerës së kërkesave (arkëtimeve) afatshkurtëra, fshirjen e kërkesave (arkëtimeve) nga CRCO dhe të tjera, ndërsa në krahasim me kostot e planifikuara për vitin 2020 janë rritur për 20%, për shkak të rritjeve të pritshme për vitin 2021 të kostove për harmonizimin e vlerës së kërkesave afatshkurte dhe fshirjen e kërkesave nga CRCO, si pasojë e pandemisë Kovid-19 dhe ndikimit negativ të saj ndaj operacioneve financiare të kompanive ajrore.
  - **Amortizimi është planifikuar në vlerë prej 58.500.000,00 denarëve, sipas nomenklaturës së përlllogaritjes së amortizimit dhe politikës së kontabilitetit të Shoqërisë dhe e njëjta është ulur për 2,5%, në raport me atë të vitit 2020, duke marrë parasysh realizimin e investimeve të planifikuara për vitin 2020 dhe realizimit të pritshëm për vitin 2021.**
  - **Kostot financiare totale të planifikuara për vitin 2021 janë planifikuar me vlerën e 15.000.000,00 denarëve,** prej të cilave vlera më e madhe prej 12.000.000,00 denarësh është pagesa e planifikuar e interesit për mjetet e tërhequra dhe të patërhequra të Shoqërisë sipas Marrëveshjes së Huasë të lidhur me EBOR-in më 24 shtator të vitit 2013, ndërsa kostot e planifikuara të shërbimeve bankare janë planifikuar me vlerë prej 3.000.000,00 denarësh. Këto kosto janë në rënie për 34,8% në krahasim me kostot e planifikuara për vitin 2020 për shkak të dinamikës së ulët të realizimit të investimeve të planifikuara të financuara me huanë nga EBOR-i në vitin 2020, si dhe dinamikës së ulët të pritshme të realizimit të të njëjtave edhe në vitin 2021, për shkak të pasojave të pandemisë Kovidin-19 dhe thirrjes së klauzolës së Fuqisë Madhore në disa prej kontratave të lidhura për realizimin e projekteve.



Pasqyra tabelare e shpenzimeve të planifikuara të Shoqërisë për vitin 2021 krahas shpenzimeve të planifikuara të Shoqërisë për vitin 2020 është dhënë në Pikën 11 – “Analiza krahasuese e shpenzimeve të planifikuara të SHA “M-NAV” Shkup për vitin 2021 me shpenzimet e planifikuara të Shoqërisë për vitin 2020.

## **8. REZULTATI FINANCIAR I PLANIFIKUAR PËR VITIN 2021**

SHA “M-MNAV” Shkup përpunoi Planin Financiar për vitin 2021, në përputhje me dispozitat e Ligjit të Shoqërive Tregtare (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr 28/2004, 85/2005, 25/2007, 87/2008, 42/10, 48/10, 24/11, 166/12, 70/13, 119/13, 120/13, 187/13, 38/14, 41/14, 138/14, 88/15, 192/15, 6/16, 30/16, 61/16, 64/18 dhe 120/18) dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Projektimet e shpenzimeve totale në vlerë prej **777.687.000,00** denarësh (Pika 6) janë bërë sipas analizave për funksionimin e SHA “M-NAV” përgjatë dy viteve paraprake, si dhe sipas mjeteve minimale të nevojshme të Shoqërisë për mirëmbajtjen e cilësisë së shërbimeve të saj në vitin 2021, në përputhje me principet e parimit të kontabilitetit mbi parimin e bazës së përllogaritjes.

Sipas rregulloreve të ICAO-së dhe Eurocontrol-it, ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror në Republikën e Maqedonisë së Veriut, SHA “M-NAV” Shkup, punon me parimin e kthimit total të kostove (*full cost recovery*) të punës, të cilat Eurocontrol-i i miraton çdo vit. Kjo nënkupton se sipas “Parimeve” të Eurocontrol-it (dok.nr. 20.60.01 nga janari i vitit 2020), fitimi i realizuar për vitin e kaluar përllogaritet si detyrim për vitin vijues, ku i njëjti iu kthehet kompanive ajrore nëpërmjet uljes përkatëse të çmimit të shërbimeve, përkatësisht në përllogaritjen e dhënë, një pjesë e fitimit për vitin 2018 në vlerë prej 44.811.500,00 denarëve transferohet në vitin 2021 dhe për vlerën e tillë ul bazën e kostove për përllogaritjen e çmimit të njësisë në vitin 2021.


Projektimet e të ardhurave totale në vlerë prej **738.883.007,00** denarësh, bazohen sipas vëllimit të planifikuar të trafikut ajror për vitin 2021 (ika 6).

**Me realizimin e të gjitha parashikimeve të planifikuara, SHA “M-NAV” Shkup pret që gjatë vitit 2021, shpenzimet e planifikuara totale t’i tejkalojnë të ardhurat e planifikuara totale, ku do të pësojë humbje për 38.803.993,40 denarë.**

Siç theksuam më lartë, sipas “Parimeve” të lartpërmendura të Eurocontrol-it, SHA “M-NAV” Shkup vepron sipas metodologjisë së kthimit të plotë të kostove, që nënkupton se vlera eventuale e humbjes së fituar për vitin 2021 do të zhvendoset gjatë viteve vijuese, përkatësisht SHA “M-NAV” Shkup, do t’i kthejë këto mjete nëpërmjet rritjes së bazës së kostove në vitin 2023, d.m.th. humbja e projektuar për vitin 2021 do të mbulohet me pjesën e fitimit të realizuar gjatë viteve të kaluara, si dhe me fitimin potencial që do të fitohet viteve në vijim, me normalizimin e trafikut ajror.

9. PASQYRA TABELARE E TË ARDHURAVE TË PLANIFIKUARA TË SHA "M-NAV" SHKUP PËR VITIN 2021

<u>TË ARDHURAT</u>	<u>Q1</u>	<u>Q2</u>	<u>Q3</u>	<u>Q4</u>	<u>GJITHSEJ</u>
<b>FLUTURIMET</b>	64.625.843,20	170.668.460,22	264.899.547,36	144.740.972,32	<b>644.934.823,10</b>
<b>SHËRBIMET TERMINALE</b>	9.645.676,24	19.568.992,50	29.648.772,14	23.084.742,58	<b>81.948.183,46</b>
<b>TË ARDHURAT E TJERA</b>	3.000.000,00	3.000.000,00	3.000.000,00	3.000.000,00	<b>12.000.000,00</b>
<b><u>GJITHSEJ DENARË</u></b>	<b>77.271.519,44</b>	<b>193.237.452,72</b>	<b>297.548.319,50</b>	<b>170.825.714,90</b>	<b><u>738.883.006,60</u></b>




**10. PASQYRA TABELARE E SHPENZIMEVE TË PLANIFIKUARA TË SHA "M-NAV" SHKUP PËR VITIN 2021**

<u>SHPENZIMET</u>	<u>Q1</u>	<u>Q2</u>	<u>Q3</u>	<u>Q4</u>	<u>GJITHSEJ</u>
<b>Kostot totale të të punësuarve</b>	<b>139.010.000,00</b>	<b>139.010.000,00</b>	<b>140.921.000,00</b>	<b>140.921.000,00</b>	<b>559.862.000,00</b>
Pagat bruto	137.760.000,00	137.760.000,00	139.671.000,00	139.671.000,00	554.862.000,00
Kostot e tjera të të punësuarve					

	1.250.000,00	1.250.000,00	1.250.000,00	1.250.000,00	5.000.000,00
<b>Kostot materiale totale</b>	<b>17.800.000,00</b>	<b>17.800.000,00</b>	<b>17.800.000,00</b>	<b>17.800.000,00</b>	<b>71.200.000,00</b>
Lëndët e para të konsumuara dhe materialet	1.000.000,00	1.000.000,00	1.000.000,00	1.000.000,00	4.000.000,00
Pjesët rezervë të konsumuara	3.000.000,00	3.000.000,00	3.000.000,00	3.000.000,00	12.000.000,00
Energjia e konsumuar	4.000.000,00	4.000.000,00	4.000.000,00	4.000.000,00	16.000.000,00
Shërbimet e transportit	1.250.000,00	1.250.000,00	1.250.000,00	1.250.000,00	5.000.000,00
Shërbimet postare, telefonike dhe interneti	4.250.000,00	4.250.000,00	4.250.000,00	4.250.000,00	17.000.000,00
Kostot e mirëmbajtjes	3.800.000,00	3.800.000,00	3.800.000,00	3.800.000,00	15.200.000,00
Kostot e përcaktuara shtesë të viteve të kaluara	500.000,00	500.000,00	500.000,00	500.000,00	2.000.000,00
<b>Kostot totale jomateriale</b>	<b>17.656.250,00</b>	<b>20.156.250,00</b>	<b>13.906.250,00</b>	<b>15.406.250,00</b>	<b>67.125.000,00</b>
Dhënia me qira e hapësirës për zyrë	0,00	0,00	750.000,00	750.000,00	1.500.000,00
Shërbimet e tjera	250.000,00	250.000,00	250.000,00	250.000,00	1.000.000,00
Mëditjet e udhëtimit zyrtar dhe kostot e udhëtimeve					


	1.000.000,00	4.000.000,00	4.000.000,00	6.000.000,00	15.000.000,00
Kostot e përfaqësimit	500.000,00	500.000,00	500.000,00	500.000,00	2.000.000,00
Premitë e sigurimit	500.000,00	9.000.000,00	1.000.000,00	500.000,00	11.000.000,00
Tarifat e anëtarësimit në organizata dhe të tjerë	406.250,00	406.250,00	406.250,00	406.250,00	1.625.000,00
Kostot e tjera jomateriale	15.000.000,00	6.000.000,00	7.000.000,00	7.000.000,00	35.000.000,00
<b>Kostot e tjera të punës</b>	<b>0,00</b>	<b>0,00</b>	<b>0,00</b>	<b>6.000.000,00</b>	<b>6.000.000,00</b>
<b>Amortizimi</b>	<b>14.625.000,00</b>	<b>14.625.000,00</b>	<b>14.625.000,00</b>	<b>14.625.000,00</b>	<b>58.500.000,00</b>
<b>Kostot totale financiare</b>	<b>3.250.000,00</b>	<b>3.750.000,00</b>	<b>4.000.000,00</b>	<b>4.000.000,00</b>	<b>15.000.000,00</b>
Shërbimet bankare -komisionet	750.000,00	750.000,00	750.000,00	750.000,00	3.000.000,00
Interesi i kredive bankare	2.500.000,00	3.000.000,00	3.250.000,00	3.250.000,00	12.000.000,00
<b><u>GJITHSEJ DENARË</u></b>	<b>192.341.250,00</b>	<b>186.841.250,00</b>	<b>191.252.250,00</b>	<b>207.252.250,00</b>	<b>777.687.000,00</b>



**11. ANALIZA KRAHASUESE E SHPENZIMEVE TË PLANIFIKUARA TË SHA “M-NAV” SHKUP PËR VITIN 2021 ME SHPENZIMET E PLANIFIKUARA TË SHOQËRISË PËR VITIN 2020**

PËRSHKRIMI I SHPENZIMEVE	SHPENZIMET E PLANIFIKUARA PËR VITIN 2021	SHPENZIMET E PLANIFIKUARA PËR VITIN 2020	SHPENZIMET E PLANIFIKUARA 2021/2020 (%)
<b>Kostot totale të të punësuarve</b>	<b>559.862.000,00</b>	<b>801.800.000,00</b>	<b>-30,17</b>
Pagat bruto	554.862.000,00	793.800.000,00	-30,1
Kostot e tjera të të punësuarve	5.000.000,00	8.000.000,00	-37,5
<b>Kostot totale materiale</b>	<b>71.200.000,00</b>	<b>97.800.000,00</b>	<b>-27,2</b>
Lëndët e para të konsumuara dhe materialet	4.000.000,00	4.000.000,00	0,0
Pjesët rezervë të konsumuara	12.000.000,00	30.000.000,00	-60,0
Energjia e konsumuar	16.000.000,00	15.800.000,00	1,3
Shërbimet e transportit	5.000.000,00	5.000.000,00	0,0
Shërbimet postare, telefonike dhe interneti	17.000.000,00	17.000.000,00	0,0
Kostot e mirëmbajtjes	15.200.000,00	24.000.000,00	-36,7
Kostot e përcaktuara shtesë të viteve të kaluara	2.000.000,00	2.000.000,00	0,0
<b>Kostot totale jomateriale</b>	<b>67.125.000,00</b>	<b>123.400.000,00</b>	<b>-45,6</b>
Dhënia me qira e hapësirës për zyrë	1.500.000,00	6.000.000,00	-75,0
Shërbimet e tjera	1.000.000,00	1.000.000,00	0,0
Mëditjet e udhëtimit zyrtar dhe kostot e udhëtimeve	15.000.000,00	35.000.000,00	-57,1
Kostot e përfaqësimit	2.000.000,00	2.500.000,00	-20,0
Premitë e sigurimit	11.000.000,00	12.000.000,00	-8,3
Tarifat e anëtarësimit në organizata dhe të tjera	1.625.000,00	1.900.000,00	-14,5

Kostot e tjera jomateriale	35.000.000,00	65.000.000,00	-46,15
<b>Kostot e tjera të punës</b>	<b>6.000.000,00</b>	<b>5.000.000,00</b>	<b>20,0</b>
<b>Amortizimi</b>	<b>58.500.000,00</b>	<b>60.000.000,00</b>	<b>-2,5</b>
<b>Kostot financiare totale</b>	<b>15.000.000,00</b>	<b>23.000.000,00</b>	<b>-34,8</b>
Shërbimet bankare - provizioni	3.000.000,00	6.000.000,00	-50,0
Interesi i kredive bankare	12.000.000,00	17.000.000,00	-29,4
<b><u>GJITHSEJ DENARË</u></b>	<b>777.687.000,00</b>	<b>1.111.000.000,00</b>	<b>-30,0</b>



**Vërejtje:** Devijimet e kostove të planifikuara për vitin 2021 krahasuar me kostot e planifikuara për vitin 2020, janë shpjeguar në tekstin e mësipërm në pikën 7 – **Analiza e shpenzimeve të planifikuara të Shoqërisë për vitin 2021.**




<u>PËRSHKRIMI I SHPENZIMEVE</u>	<u>SHPENZIMET E PLANIFIKUARA PËR VITIN 2021</u>	<u>SHPENZIMET E REALIZUARA PR VITIN 2020</u>	<u>TË PLANIFIKUARA 2021/TË REALIZUARA 2020 (%)</u>
---------------------------------	---	--	--

**12. ANALIZAT KRAHASUESE E SHPENZIMEVE TË PLANIFIKUARA TË SHA "M-NAV" SHKUP PËR VITIN 2021 ME SHPENZIMET E PLANIFIKUARA TË SHOQËRISË PËR VITIN 2020**

<b>Kostot totale të të punësuarve</b>	<b>559.862.000,00</b>	<b>715.627.370,00</b>	<b>-21,77</b>
Pagat bruto	554.862.000,00	709.711.199,00	-21,82
Kostot e tjera të të punësuarve	5.000.000,00	5.916.171,00	-15,49
<b>Kostot totale materiale</b>	<b>71.200.000,00</b>	<b>52.722.437,14</b>	<b>35,05</b>
Lëndët e para të konsumuara dhe materialet	4.000.000,00	1.441.843,00	177,42
Pjesët e tjera rezervë	12.000.000,00	7.602.142,00	57,85
Energjia e konsumuar	16.000.000,00	10.003.170,00	59,95
Shërbimet e transportit	5.000.000,00	1.777.316,00	181,32
Shërbimet postare, telefonike dhe interneti	17.000.000,00	16.134.445,62	5,36
Kostot e mirëmbajtjes	15.200.000,00	13.735.852,52	10,66
Kostot e përcaktuara shtesë viteve të kaluara	2.000.000,00	2.027.668,00	-1,36
<b>Kostot totale jomateriale</b>	<b>67.125.000,00</b>	<b>72.029.972,35</b>	<b>-6,81</b>
Dhënia me qira e hapësirës për zyrë	1.500.000,00	1.500.000,00	0,00
Shërbimet e tjera	1.000.000,00	477.791,00	109,30
Ditarët e udhëtimit zyrtar dhe kostot e udhëtimeve	15.000.000,00	11.093.942,59	35,21
Kostot e përfaqësimit	2.000.000,00	1.693.820,02	18,08
Premitë e sigurimit	11.000.000,00	10.202.352,00	7,82
Tarifat e anëtarësimit në organizata dhe të tjera	1.625.000,00	1.664.444,00	-2,37
Kostot e tjera jomateriale	35.000.000,00	45.397.622,74	-22,90
<b>Kostot e tjera të punës</b>	<b>6.000.000,00</b>	<b>1.963.814,60</b>	<b>205,53</b>
<b>Amortizimi</b>	<b>58.500.000,00</b>	<b>60.000.000,00</b>	<b>-2,50</b>
<b>Kostot financiare totale</b>	<b>15.000.000,00</b>	<b>15.151.511,06</b>	<b>-1,00</b>

Shërbimet bankare - provizioni	3.000.000,00	2.151.819,59	39,42
Interesi i kredive bankare	12.000.000,00	12.999.691,47	-7,69
<b><u>GJITHSEJ DENARË</u></b>	<b>777.687.000,00</b>	<b>917.495.105,15</b>	<b>-15,24</b>



Sipas analizës krahasuese të shpenzimeve të planifikuara të Shoqërisë për vitin 2021 (777.687.000,00 denarë) krahas shpenzimeve të realizuara të pritshme të Shoqërisë për vitin 2020 (917.495.105,15 denarë), pritet rënie me 15,24% në raport me realizimin gjatë vitit 2020.

Mbi të gjitha theksojmë se gjatë kumtimit të shpenzimeve të realizuara në vitin 2020, për arsye se në kohën e përgatitjes së Planit Financiar të vitit 2021, ato akoma nuk ishin plotësisht të disponueshme, janë marrë të dhënat aktuale që nga data 30.9.2020. Për periudhën e ngelur të vitit 2020, janë marrë shpenzimet e planifikuara të Planit Financiar të Shoqërisë për vitin 2020, përveç nënplikës – kostot për sigurimin e veprimtarisë, ku për qëllimet e projeksonit më real të tremujorit të fundit të vitit 2020, është përlogaritur vlera e kësaj kostoje prej 9.000.000,00 denarësh në tremujorin e fundit të vitit 2020, sepse kjo kosto ishte planifikuar paraprakisht në tremujorin e tretë të vitit 2020, por ajo nuk u realizua dhe do të transferohet në tremujorin (e katërt) të 2020-ës.

Si rezultat i të dhënave më sipër, ky devijim nuk është plotësisht real, d.m.th. devijimi i

saktë do të shihet në fund të vitit, kur do të shënohen plotësisht kostot e vitit 2020.

Në fakt, sipas analizës krahasuese, devijimi i shpjeguar i zërave individualë të shpenzimeve është si rezultat nga:

- Kostot e planifikuara për pagat bruto të të punësuarve në “M-NAV” për vitin 2021 në raport me kostot e realizuara për vitin 2020, sipas tabelës së mësipërme kanë rënë me 21,82%, por realizimi i pagave bruto në vitin 2020 është në rënie me 30% për muajin prilli dhe muajin maj, ndërkohë për muajt qershor dhe dhjetor të 2020-ës me 10%, sipas masave ekonomike antikrizë të miratuara më 03.4.2020 nga ana e Bordit të Drejtorëve të “M-NAV”-it në fillim të pandemisë Kovid-19. Siç mund të shihet, nga analiza krahasuese e shpenzimeve të planifikuara të SHA “M-NAV” Shkup për vitin 2021 me shpenzimet e planifikuara të Shoqërisë për vitin 2021 (Pika 11), pagat bruto të Shoqërisë për vitin 2021 kanë rënë me 30,1%, krahas të planifikuarave për vitin 2020.

- Kostot e planifikuara për lëndët e konsumuara dhe materialet për vitin 2021, krahasuar me kostot e realizuara për vitin 2020, dëshmojnë rritje drastike për shkak se të nënçerë, materialet e zyrës, produktet e higjienës dhe të ujit janë të nevojshme nga depoja, ndërsaq të dhënat shkarkohen nga depoja në fund të vitit dhe pas shkarkimit, të ky zë, nuk do të ketë më përqindje të tillë të devijimit në fund të vitit pas regjistrimit të kostove.

- Te zërat, kryesisht, tek ato për shërbimet e transportit dhe shërbime të tjera, ku tregohet realizim i ulët gjatë vitit 2020 dhe pjesërisht edhe te zërat e tjerë të shpenzimeve, devijimi i së realizuarës ndaj të planifikuarës, varet nga përdorimi real i reduktuar i shërbimeve të transportit, shpërndarjes dhe logjistikës, transportit të të punësuarve, realizimit të ulët të furnizimeve publike dhe investimeve kapitale, si rezultat i ndikimit të pandemisë Kovid-19 ndaj veprimtarisë financiare të “M-NAV”-it si dhe masave ekonomike antikrizë të ndërmarra nga Bordi i Drejtorëve pas fillimit të pandemisë. Sidoqoftë, edhe për këta zëra të kostove, realizimi i saktë do të shihet në fund të vitit, pas regjistrimit përfundimtar të kostove për vitin 2020.

- Kostot e tjera të punës të planifikuara gjatë vitit 2021, krahas kostove të realizuara gjatë vitit 2020, dëshmojnë për një rritje drastike për shkak se numri më i madh i këtyre kostove (kostot e rregullimit të vlerës së arkëtimeve afatshkurte dhe shlyerjet e arkëtimeve nga CRCO-Eurocontrol-i), regjistrohen në fund të vitit dhe pas regjistrimit përfundimtar të të njëjtëve të ky zë, nuk do të ketë përqindje të tillë të devijimit në fund të vitit.

- Shpenzimet e planifikuara për udhëtime zyrtare dhe mëditje gjatë vitit 2021, kanë pësuar rritje krahas realizimit të pritur të kostove për vitin 2020, për shkak të trajnimeve të planifikuara të personelit të aviacionit në vitin 2021 dhe gjithashtu pas bllokimit të plotë të aktiviteteve ndërkombëtare gjatë vitit 2020, ndërprerjes së pritshme nga pandemia Kovid-19 dhe normalizimit gradual të aktiviteteve të Shoqërisë në gjysmën e dytë të vitit 2021.